



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 327 Akti

Nr. 366 Vendimi
Tiranë, më 15.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Maria Tuma, në datën 15.4.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Tasim Puci**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Tasim Puci, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.11.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.11.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues z. Olsi Komici. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhguese ndërkombëtare për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Maria Tuma. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Në datën 17.3.2021 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ.

Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasurinë në vite;*
- *ka fshehje të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë,*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar² ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë³ ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas

¹Me shkresën me nr. **** prot., datë 19.1.2018.

²Me shkresën nr. **** prot., datë 17.6.2020, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ****, datë 22.6.2020, të KDZH-së.

³Me shkresën nr. **** prot., datë 8.7.2020, dërgohet raporti i KLP-së.

një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 17.3.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar në të tria kriteret: në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Tasim Puci, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për një proces të rregullt ligjor subjektit të rivlerësimit, z. Tasim Puci, i janë garantuar të drejtat, si: të njoftohet për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 17.3.2021, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

Z. Tasim Puci, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 27.3.2021. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni.

Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 8.4.2021. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 13.4.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Maria Tuma.

Në përfundim, të seancës dëgjimore, subjekti nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Tasim Puci, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Tasim Puci, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësisë për fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas shtojcës 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti ka deklaruar:

1. **Automjet⁴**, blerë në vitin 2012, tip “D. C”, me targa AA *** AE (e paregjistruar në DPSHTRR), në vlerën 500.000 lekë, me burim nga kursimet e pagës.

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitblerje automjeti nr. ****, datë 27.6.2012, në shumën 500.000 lekë; rezultatet e kërkimit regjistri i barëve sigurorese; prokurë e posaçme për përfaqësimin e palës shitëse të automjetit.

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRr-ja⁵ konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të (bashkëshortja dhe fëmijët) nuk kanë automjete në pronësi.

Nga verifikimi i akteve, rezulton se subjekti ka nënshkruar kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 27.6.2012, në shumën 500.000 lekë, shumë e shlyer tërësisht jashtë zyrës noteriale. Subjekti, që në momentin e blerjes, ka qarkulluar me këtë automjet pa leje qarkullimi.

Komisioni ka konstatuar se referuar legjislacionit në fuqi dhe nenit 93 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në momentin e blerjes në datën 27.6.2012, duhet të ishte kryer transferimi i pronësisë së automjetit në emër të subjektit. Me regjistrimin e automjetit duhet të lëshoheshin edhe dokumentet përkatëse si lejeqarkullimi dhe certifikata e pronësisë në emrin e tij.

Subjekti është pyetur nga Komisioni për shkakun e mosregjistrimit të kësaj pasurie në emër të tij, si dhe i është kërkuar të depozitojë dokumentacionin që disponon mbi përdorimin e këtij automjeti.

Subjekti⁶ ka shpjeguar se automjeti i tij është tip “R S****” me targa AA *** AE dhe jo automjeti tip “D.C” dhe se ka qëndruar gjatë gjithë kohës në Berat dhe nuk e ka përdorur këtë automjet, pasi puna me banesën me qira është vetëm 500 metra larg. Për shkak të ngarkesës së punës dhe dyshimit për vazhdimin e jetës në Berat apo në Tiranë ka ngelur pa regjistruar. Automjetin e ka aktualisht në prokurori ku e ka mbajtur gjithmonë.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se disponon një automjet tip “D.C ***D”, me targa AA ***A AE, e paregjistruar në DPSHTRR. Nga verifikimi i deklaramëve evidentohet se nga subjekti janë deklaruar në mënyrë të pasaktë të dhënat e automjetit.

Nga verifikimi në sistemin e AMF-së, me të dhënat e targës AA *** AE, nuk ka rezultuar e paguar asnjë policë sigurimi. Referuar sistemit të AMF-së dhe përgjigjes së DPSHTRr-së, për subjektin Tasim Puci, nuk rezulton asnjë e dhënë, që do të thotë se subjekti edhe për automjetin e mëparshëm që ka disponuar nuk është pajisur me dokumentacion ligjor të detyrueshëm.

DPSHTRr-ja⁷ ka depozituar dosjen e plotë të automjetit me targa AA *** AE. Nga aktet e dosjes rezulton se ky automjet figuron akoma në pronësi të shtetasit N.D, automjet i cili më parë ka qenë i regjistruar me targa EL ****.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁸, ka depozituar informacion në lidhje me masa administrative gjoba të vendosura ndaj automjetit me targa AA **** AE.

Nga ky institucion rezulton se automjeti me targa AA **** AE, i tipit “M/D. C” është në pronësi të shtetasit N. S. D, me banim në Elbasan. Automjetit me targa AA *** AE, i janë vendosur 2 gjoba, të cilat janë të pa likuiduara, me të dhënat si vijon:

- në datën 15.6.2020, gjobë në shumën 1.000 lekë, me status të papaguar dhe kundërvajtësi nuk ka qenë prezent, për shkelje të parashikuara nga neni 156/6 i Kodit Rrugor; dhe
- në datën 4.8.2016, gjobë me status të papaguar me kundërvajtës Tasim Puci, për shkelje të parashikuara nga neni 79/10, 124/1/11, 191/1/2.

Nga dokumentacioni i administruar rezultoi një vendim në lidhje me një kundërvajtje administrative me nr. *****, datë 12.8.2016, të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë,

⁵ Në shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2020.

⁶ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 25.6.2020.

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2021.

⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2021,

për shtetasin Tasim Puci, ku është konstatuar se ky shtetas ka drejtuar automjetin me targa AA *** AE, në pronësi të shtetasit N.D, pa kryer kontrollin teknik vjetor me më shumë se një muaj, si dhe pa kryer sigurimin e detyrueshëm të automjetit me lejdrejtimi nr. ****, që i ka kaluar afati i vlefshmërisë. Masa e dënimit, ndaj subjektit për këtë kundërvajtje në shumën prej 40.000 lekësh, rezulton e palëkundura.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se:

- Ndryshe nga çfarë ka deklaruar për këtë automjet, subjekti jo vetëm që e ka përdorur, por edhe është gjobitur për mospajisjen me dokumentacionin përkatës.

1.2 Analiza financiare

Komisioni ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e blerjes me burime të ligjshme të automjetit në datën 27.6.2012, ku u morën në konsideratë:

- a. Të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimit për të ardhurat *neto* nga paga për subjektin e rivlerësimit⁹.
- b. Shpenzimet, ku u morën në konsideratë:
 - shpenzimet e jetesës, për periudhën janë bazuar në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së¹⁰;
 - shpenzimet për qiranë u bazuan në deklaratimet e subjektit; dhe
 - shpenzimet për blerje automjeti u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, si dhe në dokumentacionin¹¹ përkatës.

Për analizimin e kursimeve u morën në konsideratë gjendjet e likuiditeteve në bankë bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

Përshkrimi	Datë 27.6.2012
Pasuri	319 878
Automjet tip “D. C” blerë më 27.6.2012	500 000
Diferencë likuiditeti	-180 122
Detyrime	-
Pasuri <i>neto</i>	319 878
Të ardhura	279 096
Të ardhura nga paga e subjektit	279 096
Shpenzime	315 096
Shpenzime jetese	279 096
Shpenzime qiraje (deklaruar nga subjekti në pyetësor)	36 000
Likuiditete në fund	-192 585
Gjendje <i>cash</i>	
Llogari page në “Raiffeisen Bank”, subjekti	-197 585
Llogari në “Abi Bank” (shpërblimi i lindjes së djalit)	5 000
Rezultati financiar	- 355 878

1.3 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, u konstatua:

- deklarim i remë në lidhje me përdorimin e automjetit;
- mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit në shumën 355.878 lekë, në vitin 2012;

⁹ Sipas vërtetimit nr. ***, datë 5.1.2017, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹⁰ Shkresë nr.**** prot., datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

¹¹ Informacioni i dorëzuar nga DPSHTRr-ja.

- mosregjistrimi i automjetit në DPSHTRR në pronësi të subjektit, prej vitit 2012 dhe në vijim, me qëllim shmangien e pagesave në lidhje me policat e sigurimit, taksat e detyrueshme, si dhe kryerjen e kontrollit teknik të automjetit.

1.4 Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

1.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në prapësimet e depozituara të datës 27.3.2021, ka kundërshtuar gjetjet e Komisionit, duke argumentuar si vijon:

i. Subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur njohje me shitësin e këtij automjeti dhe pronari i saj nëpërmjet një prokure ka autorizuar një person tjetër për të kryer shitjen, kjo shpjegon edhe arsyet pse nuk e njeh shitësin e automjetit dhe ka deklaruar se nuk ka pasur konflikt interesi.

ii. Lidhur me gjendjen negative që ka rezultuar nga analiza e kryer nga Komisioni në shumën 355.878 lekë, ka kundërshtuar rezultatin negativ, duke argumentuar se çdo familje mundohet të mbajë kursime për shpenzime të ndryshme familjare. Subjekti shpjegoi, gjithashtu, se asnjëherë nuk i ka bërë me llogaritje analitike, por është munduar që me pagën dhe kursimet të plotësojë nevojat e domosdoshme familjare, pasi nuk ka pasur asnjëherë shuma të mëdha parash që të mund t'i administronte ndryshe nga ana financiare. Subjekti, më tej, sqaron se për blerjen e automjetit ca para i kishte kursyer e ca të tjera i kishte marrë hua.

Një prokuror që ushtron detyrën prej vitit 1998 – 2012, blen një makinë në vlerën 500.000 lekë dhe konstatohet si shkelje financiare mosjustifikimi i shumës në vlerën 355.878 lekë (pa u marrë në konsideratë që prokurori për aq vite punë mund edhe të ketë kursyer diçka), konsiderohet si diçka jo e drejtë për arritjen e konkluzioneve të tilla, duke mos harruar ILKDPKI-ja, që dosja e deklarimeve daton që prej vitit 2003 e në vazhdim.

iii. Në lidhje me gjokat e vendosura, subjekti ka shpjeguar se kanë qenë dy raste kur ka përdorur automjetin, njërin kur duhet të dërgonte nënën në spital në Dibër dhe tjetra gjatë kohës së pandemisë, kur duhet të sillte djalin në Tiranë për provimin e maturës, pasi është nxënë në shkollën jopublike “F. K”.

iv. Në lidhje me mospajshjen me dokumentacion dhe mosregjistrimin e automjetit, subjekti ka shpjeguar se leja e drejtimit të automjetit që kishte skaduar në vitin 2014, e ka rinovuar në datën 27.12.2020. Neglizhenca ka ardhur si pasojë e mospërdorimit të tij, si dhe prej mbingarkesës së punës, pasi ka ngarkesën më të madhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, si në çështje, urdhra ekzekutimi, marrëdhënie me shërbimin e provës, I. E. V. P, letërporositë etj., e vërtetuar kjo edhe nga statistikat që Komisioni dispononi. Nuk kam pasur asnjëherë qëllim shmangien e taksave, policave apo kryerjen e kontrollit teknik.

1.6 Analiza ligjore

i. Komisioni, në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme të rezultuar nga analiza financiare, arsyeton se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk mund të pranohen, pasi subjekti referuar DPV-ve periodike ndër vite, nuk ka deklaruar kursime *cash* dhe as marrjen e ndonjë huaje, sikurse ka pretenduar për blerjen e automjetit. Për rrjedhojë, subjekti ka rezultuar me pamjaftueshmëri likuiditetesh për blerjen e automjetit. Në lidhje me shumën e marrë hua, subjekti nuk e ka deklaruar në DPV-të periodike, nuk e ka deklaruar gjatë hetimit të kryer, si dhe nuk e mbështeti me dokumentacion provues ligjor.

Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj

dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

ii. Në lidhje me mosregjistrimin e automjetit të blerë në vitin 2012 nga subjekti, Komisioni arsyeton se një sjellje e tillë është e papranueshme dhe për një qytetar të zakonshëm dhe jo më për një prokuror. Kjo sjellje e subjektit është kryer në mënyrë të përsëritur për një periudhë të gjatë edhe pasi ndaj tij janë vendosur gjoba të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Referuar dispozitave ligjore të parashikuar nga nenet 79¹², 24¹³, dhe 191¹⁴, të ligjit 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është e papranueshme për një prokuror të mos kryejë regjistrimin e automjetit, mospajisjen me lejeqarkullimi, pagimin e detyrimit të taksave vjetore, kontrollin teknik, leje drejtimi të vlefshme, veprime këto të detyrueshme për të gjitha mjetet që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

GJETJE TË KOMISIONIT

2. Pasuri e llojit arë me sip. 800 m², e ndodhur në fshatin Venisht, Dibër

ILDKPKI-ja, për pasurinë e llojit arë në emër të subjektit Tasim Puci, ka konstatuar: *“Mosdeklarim i pasurisë së llojit arë me sip. 800 m², në Venisht, Dibër, e regjistruar në emër të subjektit si përfaqësues i familjes bujqësore në deklaratën Vetting dhe deklaratimet periodike vjetore ndër vite”*.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se në emër të subjektit figuron e regjistruar kjo pasuri.

ZQRPP-ja¹⁵, ka konfirmuar se z. Tasim Puci ka të regjistruar në pronësi pasurinë llojit arë me sip. 800 m², fituar si përfaqësues i familjes bujqësore me nr. ****, vol. **, f. ***, z. k. ****, Venisht, Dibër. Bashkëlidhur kartela e pasurisë me datë regjistrimi 10.7.1998 dhe AMTP-ja.

Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka shpjeguar¹⁶ se: *“Lidhur me sipërfaqen e tokës në fshat, ai është fshat i braktisur dhe nuk jeton njeri nga familja e tij. Toka është e trashëguar dhe s’kam dijeni se si është ndarë kjo tokë. Veprimet do jenë bërë nga vëllai S. P, i cili ka jetuar në fshat deri në 2010 dhe më pas është larguar në fshatin Mullet, Tiranë”*.

2.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar pasurinë e llojit arë me sip. 800m², në fshatin Venisht, Dibër, regjistruar si përfaqësues i familjes bujqësore, as në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratimet periodike vjetore ndër vite.

¹² Neni 79 Kontrolli teknik “3. Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik. Kontrolli teknik vjetor do të kryhet një herë në vit, për të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot. Për mjetet e reja me motor që hyjnë në Shqipëri, kontrolli i parë teknik do të kryhet brenda dy vjetëve nga data e regjistrimit. Pas kësaj periudhe ky kontroll kryhet për çdo vit. ...10. Cilido që qarkullon me një mjet, të cilit nuk i është kryer kontrolli teknik, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dy mijë e pesëqind deri në dhjetë mijë lekë, që dyfishohet në rast të tejkallimit të afatit të kontrollit teknik më shumë se një muaj. Për mjetet e transportit të mallrave të rrezikshme tejkallimi i ofertave të kryerjes së kontrollit teknik ndëshkohet me masa administrative me gjobë nga njëqind mijë deri në dyqind mijë lekë. Për këto shkelje merret edhe masa administrative plotësuese e tërheqjes së lejes të qarkullimit deri në kryerjen e kontrollit teknik. Për mosparaqitje brenda afateve të çdo kategorie mjetesh në qendrat e kontrollit teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me mbi 10 ditë, për çdo mjet paguhet një gjobë prej një mijë lekësh dhe për ato transporte të rrezikshme - pesë mijë lekë. Arkëtimi i gjobës bëhet nga vetë qendrat e kontrollit teknik”.

¹³ Neni 124 Afati dhe konfirmimi i vlefshmërisë së lejedrejtimet të mjetit: “1. Lejedrejtimet e kategorisë A dhe B janë të vlefshme për 10 vjet; kur janë dhënë ose janë konfirmuar për atë që e ka kaluar moshën 50 vjeç në momentin e marrjes së lejedrejtimet, janë të vlefshme për pesë vjet dhe për atë që e ka kaluar moshën 60 vjeç, në momentin e marrjes së lejedrejtimet, janë të vlefshme për tre vjet7. Cilido që drejton një mjet me një lejedrejtim që i ka kaluar afati i vlefshmërisë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë. Për këto shkelje zbatohet edhe masa administrative plotësuese e tërheqjes së lejedrejtimet.”

¹⁴ Neni 191 Detyrimi i sigurimit për përgjegjësi civile: “1. Mjetet me motor që nuk lëvizin mbi shina, duke përfshirë edhe trolejbusët e rimorkiot, nuk mund të qarkullojnë në rrugë dhe vende publike, pa qenë të siguruar sipas normave të dispozitave në fuqi për përgjegjësinë civile ndaj të tretëve. 2. Cilido që qarkullon pa qenë i siguruar, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë”.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2017, përcjell përgjigjen e ZVRPP-së Dibër. Kjo shkresë i është drejtuar ILDKPKI-së.

¹⁶ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 17.6.2020.

2.2 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

2.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Për sa i përket konstatimit, subjekti ka shpjeguar se:

Së pari kjo është një pasuri e trashëguar prej brezash nga familja e tij e fituar në bazë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, për të cilën nuk ka qenë në dijeni, pasi është larguar nga fshati që kur ishte student në Fakultetin e Drejtësisë. Sipas AMTP – së, pa numër dhe datë, të fshatit Vernisht, subjekti është pronar i 400 m² arë dhe 250 m² truall. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2017, të lëshuar nga ish-ZVRP-ja Dibër, citohet se është pronar i 800 m² arë. Sipas rregullave të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, një regjistrim i tillë është në shkelje të ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pasi dokumenti i pronësisë që është AMTP, pa numër dhe datë, tregon qartë që është pronar i 400 m² arë dhe jo i 800 m² arë.

Së dyti kartela e pasurisë së paluajtshme i përket fazës së regjistrimit të kryer nga specialistët e zyrës së regjistrimit, pasi fshati Vernisht është në proces përditësimi dhe nuk ka përfunduar me regjistrimin fillestar. Vetë procesi i përditësimit të zonave kadastrale ka procedura verifikimi, hetim dokumentacioni, fshirje regjistrimi apo regjistrim fillestar, në varësi të dokumentacionit që duhet paraqitur nëpërmjet njoftimit me afat 45-ditor të pronarëve të akteve të pronësisë.

Për këtë arsye, nuk ka qenë në dijeni që disponon AMTP, aq më tepër, tokë arë apo truall në fshatin e lindjes.

ASHK Drejtoria Vendore Dibër me shkresën me nr. *** prot., datë 10.2.2020, në përgjigjen e drejtuar Komisionit citohet se nga verifikimi manual dhe dixhital, si dhe nga dokumentacioni që disponon Drejtoria Vendore e ASHK-së Dibër, rezulton se z. Tasim Puci dhe familjarët nuk kanë të regjistruar asnjë lloj pasurie të paluajtshme.

2.4 Analiza ligjore

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar pasurinë e llojit arë me sip. 800 m², regjistruar në emër të tij, sipas Aktit nr. ****, me datë regjistrimi 10.7.1998, në fshatin Venisht, Dibër, për të cilën nuk është lëshuar certifikatë.

Bashkëlidhur kartelës figuron AMTP-ja, pa nr. regjistrimi të aktit, sipas të cilës në mbështetje të ligjit 750, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, familjes së shtetasit T.I.P, nga fshati Venisht, i jepet në pronësi tokë gjithsej 650 m², nga të cilat 400 m² arë dhe 250 m² truall.

Ky akt rezulton të jetë nënshkruar edhe nga marrësi i tokës në pronësi shtetasi T.I.P.

Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se referuar nenit 30 të ligjit 84/2016, objekt i vlerësimit të pasurive është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve të tyre financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Trupi gjykues, në lidhje me konstatimin se subjekti nuk ka deklaruar pasurinë e llojit arë me sip. 800 m², të përfitur sipas ligjit 750/1991, “Për tokën”, të ndryshuar, në fshatin Venisht, Dibër, në përputhje me nenin 4, të ligjit 9049, datë 10.4.2003, nisur nga fakti, që fshati Vernisht është në proces përditësimi dhe nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar. Në këto rrethana, pasaktësitë dhe mospërputhjet e vetë regjistrimit në ZVRPP Dibër, me aktin e AMTP-së, nuk janë përgjegjësi e subjektit dhe mosdeklarimi prej tij, nuk duket se ka qëllim fshehjen e kësaj pasurie.

Gjithashtu, nga hetimi ka rezultuar se subjekti nuk e ka përdorur këtë pasuri, si dhe nuk ka gjeneruar të ardhura prej saj, pasuri e cila ndodhet në një zonë të largët nga zona ku subjekti

banon dhe punon, rezulton e regjistruar në regjistrin publik të ASHK-së Dibër dhe nuk mund të konsiderohet pasuri e fshehur.

Në këto kushte, duke qenë se nuk lindin dyshime për fshehje pasurie, kjo pasaktësi në deklarinimin e subjektit nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

3. Pasuria apartament, me sip. 108.4 m², ndodhur në rrugën “J. M”, Tiranë, e blerë në vlerën 4.020.528 lekë.

ILDKPKI-ja për pasurinë apartament ka konstatuar:

Fshehje e kontratës së sipërmarrjes për prenotim apartamenti me sip. 108.4 m², rruga “J. M”, Tiranë, në vlerën 4020.528 lekë, pagesën e shumës 10.000 euro në këtë periudhë, burimin e krijimit të saj dhe detyrimin e mbetur shoqërisë ndërtuese, në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2004.

Gjithashtu, rezulton mungesë e burimeve të ligjshme financiare për shlyerjen e apartamentit me sip. 108.4 m², rruga “J. M”, Tiranë, me vlerë 4.020.528 lekë, gjatë periudhës 2004 - 2011.

Fshehje e deklaratës noteriale dhe heqjes dorë nga e drejta mbi apartamentin me sip. 108.4 m², në rrugën “J.M”, Tiranë, në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2011.

Transaksione të paqarta dhe të dyshimta lidhur me prenotimin dhe shitjen e apartamentit me sip. 108.4 m², rruga “J. M”, Tiranë.

3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në vitin 2004, ka nënshkruar kontratë sipërmarrje me shoqërinë “E” sh.p.k., për prenotim të një apartamenti në Tiranë. Kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë “E” sh.p.k.¹⁷, e cila ka informuar se shtetasi Tasim Puci në vitin 2004, ka lidhur me këtë shoqëri kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti, për apartamentin me nr. ***, në rrugën “J.M”, Tiranë. Subjekti për këtë qëllim ka paguar shumën prej 10.000 euro. Në vitin 2011, me anë të deklaratës noteriale për kalim të drejtash, të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi këtë apartament i kanë kaluar z. G.H (vjerri i subjektit), duke hequr dorë Tasim Puci nga pronësia mbi këtë apartament. Në zbatim të vullnetit të shprehur nga palët, shoqëria “E” sh.p.k. në vitin 2011 ka lidhur me z. G.H, kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme apartament dhe, për këtë qëllim, ky i fundit ka paguar shumën prej 2.795.528 lekësh.

Shoqëria “E” sh.p.k., i ka bashkëlidhur përgjigjes aktet si vijon:

- a. Deklaratë për kalim të drejtash nr. ****, datë 28.12.2011, ku shtetasi Tasim Puci deklaroi se ka prenotuar pranë shoqërisë “E” sh.p.k., një apartament 2+1 me nr. 15, me sip. 108.4 m², rruga “J.M”, duke i shlyer shoqërisë të gjitha detyrimet në lidhje me këtë apartament. Këtë apartament me vullnet të lirë ia kalon shtetasit G.H, duke hequr dorë nga çdo e drejtë në favor të tij dhe, njëkohësisht, duke autorizuar dhe kërkuar nga shoqëria që kontratën përfundimtare të shitjes ta lidhë me shtetasin G.H, pa asnjë pretendim të mëtejshëm financiar apo pronësie lidhur me apartamentin në fjalë.
- b. Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. *****, datë 28.12.2011, sipas së cilës shtetasit G.H i kalon pronësia mbi apartamentin me sip. 98.12 m², me vlerë 4.020.528 lekë. Në këtë kontratë është parashikuar se çmimi i shitjes është shlyer plotësisht para nënshkrimit të kontratës.

Gjithashtu, nga shoqëria janë depozituar:

¹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2020.

- vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 20.2.2012, për pasurinë apartament me sip. 98.12 m², rruga “J. M”, në emër të G.H;
- formular i OSHEE-së për ndryshimin e emrit të kontratës së energjisë elektrike me kod klienti TR**D*****, të apartamentit në rrugën “J.M”, Tiranë, nga Tasim Puci në G. H.

OSHEE-ja¹⁸ ka informuar se në emër të shtetasit G.N.H, figuron i regjistruar 1 abonent me kontratë furnizimi nr. TR*D*****, në instancën e Tiranës, ku rezulton konsum i rregullt periodik i energjisë elektrike që nga vitit 2007.

Pasi u pyet nga Komisioni për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar se¹⁹: *“Apartamenti është në pronësi të vjehrrit, fakt i deklaruar dhe në pyetësorin e parë, si dhe gjatë deklarimeve të pasurisë në vite. Certifikatën e pronës e disponon vjehrrin që njihet si trashëgimtar i shtëpisë së bashku me nipin e tij që jeton në SHBA. Trashëgimi të cilin ai e merr nga babai që nuk jeton më.”*

Në lidhje me deklaratën noteriale nr. *****, datë 28.12.2011, subjektit iu kërkuan shpjegime me pyetësorin e datës 19.1.2021.

Subjekti ka shpjeguar²⁰ se: *“Në gusht të vitit 2002, bashkëshortja së bashku me prindërit dhe djalin e porsalindur janë shpërngulur në Tiranë, në një apartament me qira në rrugën “D. B” dhe unë shkoja fundjavave në Tiranë, pasi vetë jetoja me qira në Berat.*

Në mars të vitit 2004, jam transferuar në qytetin e Skraparit dhe në këtë kohë kam vendosur të shpërngulem dhe kam marrë familjen në Skrapar, ndërsa prindërit e bashkëshortes kanë pronotuar një apartament në Tiranë tek subjekti që ju përmendet dhe në momentin e prenotimit pallati sapo kishte filluar. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, prindërit e bashkëshortes nisur nga fakti se ndiheshin të frikësuar për shumën e parave që do të jepnin në marrëveshje me pronarin që do të ndërtonte pallatin, bën një kontratë që ai e quajti provizore thjesht si lidhje marrëveshje dhe siç e thashë për arsye se të qenit tim prokuror kërkuan që kontratën ta nënshkruaja unë dhe në momentin që apartamenti kishte përfunduar dhe do të përcaktohej pronari siç e kishim biseduar në fillim kam bërë atë deklaratë që e dispononi dhe ju.

Theksoj se kjo bisedë është bërë me pronarin në vitin 2004 dhe siç e theksova me lart veprimet kanë qenë thjesht veprime formale.

Për sa i përket dokumentacionit provues kam dërguar ato mandate që ata dispononin dhe, gjithashtu, ata kishin djalin emigrant në Itali, i cili kërkonte të kishte një banesë në qytetin e Tiranës dhe marrëdhëniet e tjera janë mes tyre dhe djalit i cili ka ndërruar jetë në vitin 2009”.

3.2 Analiza e fakteve dhe provave

Komisioni, nisur nga informacioni dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria “E” sh.p.k., si dhe nga të dhënat e rezultuara nga hetimi i kryer, bazuar në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, i ka kërkuar subjektit të provojë burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament nga vjehrrin G.H.

Sipas pretendimeve që apartament është pasuri e vjehrrit G.H, subjekti shpjegon se²¹: *“Sikurse rezulton nga mandatet e tërhequra, ato janë dorëzuar direkt pronarit të apartamentit në momentin e prenotimit të apartamentit dhe për këtë arsye ato i kanë tërhequr nga banka në këtë periudhë të prenotimit për blerje të apartamentit dhe kjo është dhe arsyeja që unë kam vënë emrin tim për garanci, pasi djali i tyre jetonte dhe punonte në Itali prej shumë vitesh. Burimet sipas asaj që kam mësuar unë, janë puna në vite si elektrikist në punë private dhe shtet e G. H (vjehrrin), puna në*

¹⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2020.

¹⁹ Datë 25.6.2020.

²⁰ Në përgjigje të pyetësorit të datës 19.1.2021.

²¹ Në përgjigjen e pyetësorit të datës 24.2.2021.

PTT e S. H, si dhe të ardhurat nga djali i tyre. Shlyerja para afatit, siç kam mësuar unë, është bërë me të ardhurat e përfiturat nga djali i tyre, pasi kishte të ardhura të mira nga punësimi në shtetin Italian”.

Subjekti ka depozituar vetëm disa mandate bankare, nga ku provohet se e ndjera S.H (vjehera e subjektit) ka depozituar në “Tirana Bank” shumën 1.200.000 lekë në datën 12.11.2002 dhe ka tërhequr shumën 1.402.434 lekë, në datën 12.11.2004. Gjithashtu, rezulton edhe një mandat lëshuar nga “Banka Italo-Shqiptare”, sipas të cilit e ndjera S.H ka hapur një depozitë njëvjeçare në shumën 1.431.618 lekë, në datën 13.11.2003. Bazuar në të dhënat e disponuara, rezulton se familja H ka disponuar këto shuma, por nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të tyre, si dhe nuk provohet destinacioni i përdorimit të tyre.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, referuar të dhënave të ardhura nga ISSh-ja²², z. G. H, ka përfitur pension pleqërie që nga muaji prill i vitit 2014 dhe aktualisht. Deri në këtë periudhë ky shtetas ka qenë i punësuar si elektrikist, pranë OSHEE-së Përmet. Nga ky punësim i rregullt, provohet që z. G.H të ketë banuar në Përmet dhe jo në apartamentin në rrugën “J. M”, Tiranë.

Komisioni, bazuar në provat e administruara në dosje për këtë pasuri, në dokumentacionin e depozituar nga shoqëria “E” sh.p.k., si dhe në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore, ka argumentuar se:

(i) nisur nga fakti që nga subjekti nuk u depozitua dokumentacion i plotë, mbi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga z. G. H; (ii) referuar kontratës së sipërmarrjes për prenotim apartamenti (sipas këtij akti subjekti ka paguar shumën prej 10.000 euro) dhe deklaratës noteriale nr. *****, datë 28.12.2011, të nënshkruar nga subjekti (ku ka deklaruar se i ka shlyer shoqërisë të gjitha detyrimet në lidhje me këtë apartament); (iii) fakti se kjo pasuri është e deklaruar nga subjekti në DPV-të në vite si adresë banimi dhe sipas regjistrimit të gjendjes civile që nga viti 2004 e në vijim; si dhe (iv) faktit që familja e subjektit e e përdor për banim nga viti 2017 dhe aktualisht, pasi fëmijët e subjektit ndjekin rregullisht studimet në Tiranë.

Komisioni, pasi ka analizuar faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit, rezulton se nuk japin informacion mbi marrëdhënien e vjehrrit të subjektit me këtë apartament të blerë në Tiranë, duke pasur parasysh se:

- shtetasi G.H jeton në Përmet;
- shtetasi G.H dhe bashkëshortja, kanë qenë të punësuar në mënyrë të vazhdueshme në Përmet;
- nga momenti i blerjes, nuk provohet ta ketë përdorur për banim apartamentin në Tiranë;
- ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti.

Për sa më sipër analizuam, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë marrëdhënien e vjehrrit me apartament në Tiranë.

- **Komisioni, bazuar në faktet dhe provat e administruara, ka ngritur dyshimin e arsyeshëm se apartament në Tiranë është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.**

3.3 Analiza financiare

Komisioni ka vlerësuar të analizojë mundësitë financiare të subjektit për likuidimin e vlerës së plotë të apartamentit për vitet 2004 dhe 2011, kur janë kryer pagesat.

Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar, u bazua në:

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2020.

- **Të ardhurat** e ligjshme sipas vërtetimit për të ardhurat *neto* lëshuar nga institucionet përkatëse për subjektin e rivlerësimit²³, të cilat janë deklaruar dhe janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- **Shpenzimet** ku u morën në konsideratë si vijon:
 - a. shpenzimet e jetesës, për periudhën 2003 – 2016, janë bazuar në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së²⁴;
 - b. shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit, u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve;
 - c. shpenzimet për qira në banesa të ndryshme u bazuan në deklaratimet e subjektit;
 - d. shpenzimet për blerje automjeti u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, si dhe në dokumentacionin²⁵ përkatës.

Për analizimin e kursimeve u morën në konsideratë:

- Deklarimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore dhe përgjigjeve në pyetësor.
- Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje në lidhje me blerjen e apartamentit në Tiranë, kanë rezultuar akte të nënshkruara nga subjekti mbi likuidimin e apartamentit, si vijon:

1. **Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti** e vitit 2004, ku shoqëria “E” sh.p.k., informon se: *“Me shtetasi Tasim Puci ka lidhur një kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti, përkatësisht apartamentin me nr. ***. Për këtë qëllim z. Tasim Puci ka paguar shumën prej 10.000 euro ...”*.
2. **Deklaratë noteriale nr. ****, datë 28.12.2011**, ku z. Tasim Puci deklaroi, ndër të tjera se: *“Ka prenotuar pranë shoqërisë ‘E’ sh.p.k. një apartament 2+1 me nr. **, me sip. 108.4m² në rrugën ‘J. M’, duke i shlyer shoqërisë ‘E’ sh.p.k. të gjitha detyrimet në lidhje me këtë apartament...”*.

Bazuar në këto akte, Komisioni ka analizuar burimet e ligjshme që kanë shërbyer për likuidimin e pagesave të kryera përkatësisht në vitet 2004 dhe 2011, në lidhje me këtë pasuri.

Nga analiza e kryer, për të vlerësuar mundësitë e subjektit të rivlerësimit për pagesat e kryera ka rezultuar se:

- për vitin 2004, mungesë burimesh të ligjshme në shumën 61.046 lekë; dhe
- për vitin 2011, mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2.605.466 lekë.

²³ Sipas vërtetimit nr. **, datë 5.1.2017, të lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat.

²⁴ Shkresë nr. ***prot., datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

²⁵ Informacioni i dorëzuar nga DPSHTRr-ja.

Pershkrimi	Pasuri	Diference likuiditeti	Detyrime	Pasuri neto	Te ardhura	Shpenzime	Rezultati Financiar
2003	-	-	-	-	702 447	332 392	370 055
2004	4 020 528	-	2 795 528	1 225 000	1 471 846	307 892	- 61 046
2005	- 29 354	- 29 354	-	- 29 354	1 487 784	354 671	1 162 467
2006	197 270	- 2 730	-	197 270	872 323	424 671	250 382
2007	72 066	72 066	-	72 066	990 836	803 904	114 866
2008	- 32 999	- 32 999	-	- 32 999	988 768	481 860	539 907
2009	- 163 102	- 163 102	-	- 163 102	737 979	533 985	367 096
2010	- 189 500	- 189 500	-	- 189 500	1 081 012	481 860	788 652
2011	333 155	333 155	- 2 795 528	3 128 683	1 141 697	618 480	- 2 605 466
2012	132 551	- 367 449	-	132 551	1 144 996	630 192	382 253
2013	260	260	-	260	1 098 815	636 096	462 459
2014	107 264	107 264	-	107 264	1 370 957	951 992	311 701
2015	- 10 651	- 10 651	-	- 10 651	1 317 415	969 104	358 962
2016	2 586	2 586	-	2 586	1 308 246	1 012 368	293 292

3.4 Përfundimisht, për këtë pasuri u konstatua se:

- ⊗ Subjekti nuk mundi të provonte me dokumentacion ligjor, burimet e ligjshme të të ardhurave të vjehrrit për blerjen e pasurisë apartament.
- ⊗ Duket se është pasuri e fshehur e subjektit, pasi ka deklaruar likuidimin e plotë të vlerës së tij.
- ⊗ Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2004:
 - i. nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes për prenotim apartamenti në Tiranë;
 - ii. nuk ka deklaruar pagesën e kryer me shumë 10.000 euro;
 - iii. nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj.
- ⊗ Nga analiza financiare ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2.666.512 lekë për blerjen e apartamentit.
- ⊗ Nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011 deklaratën noteriale mbi heqjen dorë nga të drejtat mbi apartamentin në Tiranë.

3.5 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

3.6 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti ka kundërshtuar gjetjet e Komisionit duke argumentuar se konstatimet janë totalisht të pavërteta, të pabazuara, në interpretim të gabuar të dokumentacionit që dispononte dhe në interpretim përciptazi të ligjit material, duke dalë në përfundime të paragjykuara, me mungesë përgjegjësie të plotë të deklarimeve të tyre të pavërteta.

Subjekti ka shpjeguar se nga dokumentacioni që disponon vjehri, z. G.H, për këtë apartament, rezulton se ka firmosur dhe nënshkruar me vullnet të tij të lirë me shoqërinë e ndërtimit “E” sh.p.k., aktet vijuese:

1. Kontratë sipërmarrjeje, datë 25.3.2004, e pa nënshkruar nga noteri, bashkëlidhur dhe planimetritë e apartamentit 2-5, godina *, kati *** (2+1), sip. totale: 108.4 m². Në nenin 1 të kësaj kontrate janë të dhënat identifikuese të apartamentit në ndërtim në katin e tretë të banimit me nr. * (*-*) dhe në nenin 2 të kontratës rezulton dhe çmimi real që vjehri i tij ka paguar për këtë apartament që është shuma 54.200 euro dhe jo 4.020.528 lekë që ka deklaruar shoqëria “E” sh.p.k.

Në këtë kontratë sipërmarrjeje investitori është shoqëria “E” sh.p.k., nënshkruar nga z. B.H dhe porositiësi është z. G.H, pra nuk rezulton subjekti si porositiësi i apartamentit.

Për më tepër, mandatarkëtimet me të cilat shoqëria “E” sh.p.k. merrte pagesat nga porositiësi janë në emër të vjehrit të tij, z. G. H, sipas renditjes:

- mandatarkëtimi nr. **, datë 25.3.2004, arkëtuar shuma 3.300 euro nga z. G. H për shoqërinë “E” sh.p.k.;
- mandatarkëtimi nr. **, datë 29.3.2004, arkëtuar shuma 2.300 euro nga z. G.H për shoqërinë “E” sh.p.k.;
- mandatarkëtimi nr. **, datë 12.11.2004, arkëtuar shuma 9625 euro nga z. G. H për shoqërinë “E” sh.p.k.;
- mandatarkëtimi nr. ***, datë 12.11.2004, arkëtuar shuma 11.000 euro nga z. G.H për shoqërinë “E” sh.p.k.;
- mandatarkëtimi nr. ****, datë 16.11.2004, arkëtuar shuma 12.000 euro nga z. G.H për shoqërinë “E” sh.p.k.;
- mandatarkëtimi nr. **, datë 30.4.2005, arkëtuar shuma 11.800 euro nga z. G. H për shoqërinë “E” sh.p.k.

Subjekti ka shpjeguar se vetëm mandatarkëtimi nr. ***, datë 11.4.2006, në të cilin është arkëtuar shuma prej 108.400 lekësh për shoqërinë “E” sh.p.k., është nënshkruar prej tij, për shkak se vjehri i tij, i cili në atë kohë jetonte në Përmet, kishte një problem serioz dhe dërgoi lekët e tij (vjehrit) pranë shoqërisë së ndërtimit, në mënyrë që ato të ishin në rregull me afatet e nënshkuara në kontratën e sipërmarrjes.

Subjekti shprehet se nuk di çfarë dokumentacioni ka dërguar shoqëria “E” sh.p.k., por dokumentet e nënshkuara mes të dyja palëve janë dokumentet që ka sipërcituar.

Nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *****, datë 18.11.2011, notere M. E. D, rezulton se palë blerëse e apartamentit të sipërcituar me nr. pasurie *****, vol. ***, f.***, z. k. ***, Tiranë, është z. G.H.

Firma e ndërtimit mund të ketë krijuar dokumentacion pa dijeninë e porositësit për të shmangur dhe deklarimet e vlerave reale të çmimit të apartamentit, objekt porosie, ky fakt nuk mund të më penalizojë apo të më paragjykojë mua padrejtësisht. Bashkëlidhur do ju dërgoj të gjithë dokumentacionin që disponon z. G.H në lidhje me apartamentin.

Në vijim të shpjegimeve në lidhje me mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie nga z. G. H (vjeherri), subjekti ka shpjeguar se është blerë me kursimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe nga të ardhurat që i sillte djali i tyre, që ishte në emigracion në Itali, i cili kishte arritur të siguronte një punë të mirë në sipërmarrje për bërjen e rubinetave të ujit (shkak që sipas familjarëve gjeti dhe vdekjen si pasojë e helmit që dilte nga prodhimi i tyre, por që të ardhurat ishin shumë të mira për kohën).

Subjekti ka deklaruar se konkluzioni i ILDKPKI-së është terrorizues: *“Do isha shumë i lumtur të kisha një shtëpi që të quhej imja, pasi në fund të fundit detyra ime si kryefamiljar është t’i siguroj familjes sime një strehë, por jetesa ime e vazhdueshme në Berat dhe bashkëshortja e papunë, nuk mundësuan që të gëzonim një shtëpi së bashku.*

Si mund të gjykohet kjo marrëdhënie e ndodhur shumë kohë para se të fillonte procesi i deklarimit apo vettingu, si marrëdhënie për të fshehur pasurinë.

Po kështu, fakt është edhe kontrata e OSHEE-së dhe kontrata e ujit e vitit 2007, në emër të z. G. H, për apartamentin në fjalë.

Për më tepër, nga të gjitha konfirmimet e ASHK-së në rrethe që keni kryer ju si institucion, rezultoj unë dhe anëtarët e familjes sime pa pasuri të paluajtshme”.

3.7 Analiza ligjore

Komisioni ka konstatuar se pasuria apartament e regjistruar në pronësi të vjeherit të subjektit, z. G. H, është një pasuri për të cilën subjekti nuk depozitoi dokumentacion mbi burimet e ligjshme që kishin shërbyer për krijimin e kësaj pasurie nga vjeherri dhe familjarët e tij.

Gjithashtu, subjekti as gjatë hetimit, por dhe në prapësimet e rezultateve të hetimit, nuk ka ngritur pretendimin se ndodhej në kushtet sa parashikon neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, pra në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave që kishin shërbyer si burim, të kumatit apo vjehrrës, për shkak se të dy kishin ndërruar jetë vite më parë.

Duke marrë në konsideratë rrethanat e mësipërme dhe faktet se: (i) subjekti nuk provoi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga familja H; (ii) referuar deklaratës noteriale nr. *****, datë 28.12.2011, ku subjekti ka deklaruar se i ka shlyer shoqërisë të gjitha detyrimet në lidhje me këtë apartament; (iii) apartamenti është deklaruar në deklarimet periodike në vite si adresë banimi e subjektit, si dhe sipas regjistrimit të gjendjes civile që nga viti

2004 e në vijim; dhe (iv) fakti se familja e subjektit nga viti 2017 e aktualisht e përdor për banim këtë pasuri, Komisioni ngriti dyshimin se kjo është pasuri e fshehur e subjektit.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, subjekti rezultoi me gjendje negative dhe në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

Në konkluzion, për pasurinë apartament në Tiranë në zotërim të familjes së subjektit, për faktin se nuk u provuan bindshëm të ardhurat e ligjshme për krijimin e saj, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri.

4. Nga verifikimi i llogarive bankare kanë rezultuar:

i. Transferta bankare nga llogaritë e z. G.H (vjehtëri i subjektit), në llogaritë e subjektit Tasim Puci në “Raiffeisen Bank” të paraqitura në tabelën më poshtë. Shumat totale të transferuara janë 1.365.237 lekë dhe 2.779 USD përgjatë viteve 2011 - 2012.

Numri Veprimit	Data	Pershkrim i Veprimit	Perfituesi	Urdheruesi	Shuma	Monedha
1	12/09/2011	PER SHPENZIME FAMILJARE	TASIM PUCI	G. H	150 000,00	Lekë
2	29/12/2011	KALUAR PER BLERJE MAKINE	TASIM PUCI	G. H	300 000,00	Lekë
3	08/03/2012	DHURATE	TASIM PUCI	G. H	286 237,00	Lekë
4	17/05/2012	PER KESTIN E SHTEPIVE	TASIM PUCI	G. H	200 000,00	Lekë
5	04/07/2012	DHENE HUA PER BLERJE SHTEPIE	TASIM PUCI	G. H	300 000,00	Lekë
6	16/10/2012	TRANSFERTE FAMILJARE	TASIM PUCI	G. H	129 000,00	Lekë
9	08/03/2012	DHURATE	TASIM PUCI	G. H	2 779,00	USD

Subjektit iu kërkuan shpjegime shteruese për këto veprime, si dhe të deklarojë/dokumentojë mbi burimet e ligjshme të këtyre shumave.

Në përgjigje të pyetësorit²⁶ subjekti ka deklaruar: *“Transaksionet e parave që janë bërë në numrin tim të llogarisë, janë marrëdhëniet e vjehtërit dhe bashkëshortes, për rregullimin e ambienteve të banimit dhe shpenzimeve të përditshme”*.

Subjektit iu kërkuan sërish shpjegime shteruese për këto veprime, si dhe dokumentacion justifikues për burimin e krijimit të këtyre shumave. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti nuk ka dhënë shpjegim për këto transaksione të padeklaruara në deklaratimet periodike apo në deklaratën *Vetting*.

ii. Nga verifikimi i llogarive bankare kanë rezultuar depozitime *cash* nga znj. E.P(bashkëshortja e subjektit) për z. G. H (vjehtëri i subjektit) në llogarinë pranë “Raiffeisen Bank”, në lekë. Në disa prej përshkrimeve të këtyre depozitimeve ka rezultuar komenti “kthim detyrimi”.

Shuma totale e këtyre depozitimeve ka rezultuar në vlerën 731.216 lekë, sipas tabelës vijuese:

Total	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
731 216	30 000	25 000	89 000	149 200	17 000	120 680	220 995	79 341

²⁶ Datë 17.6.2020.

Subjektit iu kërkuan shpjegime shteruese për këto veprime, si dhe dokumentacion justifikues mbi burimin e krijimit të këtyre shumave duke qenë se bashkëshortja e subjektit ka rezultuar me status si e papunë gjatë kësaj periudhe. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti nuk ka dhënë shpjegim për këto transaksione.

iii. Nga verifikimi i llogarive bankare kanë rezultuar depozitime *cash* nga z. G. H për znj. E.P në llogarinë pranë “Raiffeisen Bank”, në lekë. Shuma totale e këtyre depozitimeve ka rezultuar në vlerën 927.110 lekë, siç paraqitet në tabelën vijuese:

Total	2014	2015	2016	2017	2018	2019
927 110	44 000	216 570	193 450	240 695	229 520	2 875

Subjektit iu kërkuan shpjegime shteruese për këto veprime, si dhe dokumentacion justifikues për burimin e krijimit të këtyre shumave. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti nuk ka dhënë shpjegim për këto transaksione.

iv. Nga verifikimi i llogarive bankare kanë rezultuar gjithashtu edhe depozitime nga shtetasi A. V për znj. E.P në shuma të vogla gjatë viteve 2014 – 2016. Shuma totale ka rezultuar në vlerën 39.000 lekë dhe përshkrimi për depozitimet ka qenë “kthim detyrimi”.

Subjekti, në përgjigje të pyetësorit²⁷, ka deklaruar se: *“Lidhur me transfertat e parave me shuma të vogla, janë marrëdhëniet e bashkëshortes time me babain e saj dhe, për shkak të punës së vjehrrit, ai i ka dërguar nëpërmjet shokëve të tij si D. Xh apo A.V këto lekë janë dërguar për shpenzimet e përditshme që babai i ka dërguar vajzës për ta ndihmuar atë”*.

Trupi gjykues vlerëson se transaksionet bankare duken të paqarta nisur nga fakti se subjekti nuk ka shpjeguar dhe dokumentuar burimet e ligjshme të të ardhurave të vjehrrit, si person tjetër i lidhur në kuptim të ligjit. Edhe pas kalimit të barrës së provës në prapësime, subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të dokumentojë burimet e ligjshme të transaksioneve bankare, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Tasim Puci.

Në vijim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe në raportin me nr.

²⁷ Datë 17.6.2020.

****²⁸, datë 17.6.2020 (të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 22.6.2020, të KDZH-së).

- **Nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës ka konstatuar “papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës” për subjektin e rivlerësimit, z. Tasim I Puçi.**

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni ka verifikuar rastet e iniciuara nga institucionet e verifikimit, duke administruar të gjitha dosjet për çështjet përkatëse dhe pasi u vlerësuan në gjithë dinamikën e tyre, nuk u konstatuan shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk u evidentua ndonjë veprim i subjektit që mund të cenonte figurën apo aftësitë e tij profesionale.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirje e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshillit i Lartë i Prokurorisë²⁹ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave të dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit;
- pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, etj.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nga KLP-ja është konstatuar si vijon:

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

²⁸ Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 22.6.2020, të KDZH-së.

²⁹ Sipas aktit me shprehjen nr. *** prot., datë 8.7.2020.

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar pjesërisht. Subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka bërë plotësim të pikave 5 dhe 6 të rubrikës C të formularit, por ka bashkëlidhur gjashtë dokumente ligjore, ku tri dokumente ligjore i përkasin periudhës së rivlerësimit, dy dokumente ligjore janë të panënshkruara dhe një dokument ligjor është jashtë periudhës së rivlerësimit. Nuk rezulton të ketë mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka deklaruar të dhënat duke referuar si periudhë të rivlerësimit 1.1.2014 - 31.12.2016.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas të dhënave të deklaruara, subjekti ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për periudhën nëntor 2006 e në vazhdim.

Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore)

Referuar të dhënave arkivore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme për prokurorin, subjekt rivlerësimi Tasim Puci, rezulton se ka një masë disiplinore “vërejtje” të dhënë me urdhrin nr. ***, datë 15.5.2009, të Prokurorit të Përgjithshëm, e cila nuk i përket periudhës së rivlerësimit.

Kjo masë disiplinore bazohet në kontrollin e ushtruar nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në veprimtarinë e punës së prokurorit Tasim Puci për periudhën 1.1.2007 – 30.9.2008, ku rezulton se në punën e tij janë konstatuar të meta e dobësi, të cilat kanë ndikuar në zgjidhje të gabuara të disa procedimeve penale.

Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga gjetjet në grupet e burimeve të informacionit për periudhën e vlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, rezulton se:

Nga vlerësimet e punës së subjektit Tasim Puci për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “mirë” dhe “shumë mirë”, për dy vlerësimet vijuese, për aftësitë profesionale të tij, si në hetimet dhe gjykimet që ka ndjekur personalisht, ashtu edhe në menaxhimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që ka pasur në ndjekje.

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Tasim Puci, shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon drejtë normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet dhe zbatimin e saj në rastin konkret.

Në lidhje me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi analizës së elementëve të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin ligjor të faktit penal.

Subjekti i rivlerësimit, z. Tasim Puci, shfaq aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e provave dhe arsyetimin ligjor e logjik, duke marrë e përpiluar vendime e akte të kuptueshme me tekst të qartë.

Nga dokumentet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se ka marrë pjesë në një aktivitet profesional për ngritjen e nivelit të tij profesional.

b) Arsyetimi ligjor

Bazuar në tri aktet e dorëzuara dhe në pesë dosjet e shortuara, konstatohet se subjekti Tasim Puci shfaq aftësi në arsyetimin ligjor të akteve. Këtë e tregon mënyra e pasqyrit të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimeve të prezantuara në këto akte në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas kërkesave të ligjit. Vendimmarrja e prokurorit, subjekt vlerësimi, e pasqyruar në pjesën arsyetuese është e qartë dhe e kuptueshme, ku evidentohet referimi në bazë ligjore. Subjekti respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimmarrjes.

Në njërin prej akteve të dorëzuara dhe në njërin prej akteve të shortuara, referenca ligjore nuk është e saktë.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Tasim Puci ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ku i ka kryer hetimet, si dhe drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve.

Referuar procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së pesë dosjeve për subjektin e rivlerësimit, datë 20.2.2019, rezulton se z. Tasim Puci ka trajtuar gjithsej 988 çështje, ku 920 janë çështje të përfunduara, 78 çështje janë mbartur për vitin 2017, si dhe gjatë kësaj periudhe nga subjekti i rivlerësimit janë nxjerrë 2700 urdhërekzekutime.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Prokurori, subjekt rivlerësimi Tasim Puci, rezulton se ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme. Nga ana e tij është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të cilat janë dërguar për gjykim, si dhe sa i takon vendimmarrjes është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit, e faktuar kjo me shkresat përkatëse ose me nënshkrimin e tyre në aktet përkatëse.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale e përpiluara janë të sakta, të strukturuar, në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga prokurori rezulton se janë përmbushur kërkesat për disiplinën e punës dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara për efekt të procesit të rivlerësimit konstatohet nivel i pëlqyeshëm përgjegjshmërie, në administrimin e duhur të akteve ligjore nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, Tasim Puci, ka pasqyruar një komunikim dhe bashkëpunim korrekt me kolegët, duke shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me ta, por njëkohësisht edhe sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Tasim Puci, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Subjekti, gjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka pasur masa disiplinore.

c) Paanësia

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin Tasim Puci, për periudhën objekt vlerësimi nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jetë diskutuar cenim i të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerabël. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Subjekti i rivlerësimit, z. Tasim Puci, në periudhën e rivlerësimit ka shfaqur aftësi komunikuese të mira. Bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Subjekti i rivlerësimit ka cilësi të mira bashkëpunuese dhe tregohet i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët. Ka shfaqur aftësi dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë, duke i menaxhuar me përsosmëri këto burime.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi, subjekti Tasim Puci rezulton të jetë angazhuar në një aktivitet profesional të organizuar në rolin e pjesëmarrësit.

DENONCIME

Për prokurorin Tasim Puçi janë depozituar 16 denoncime nga publiku.

Komisioni, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pasi i vlerësoi, konstatoi se 13 prej këtyre denoncimeve nuk përmbanin fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë provë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Tasim Puci.

Subjektit iu kërkuan shpjegime për 3 denoncime, si vijojnë:

1. Denoncim depozituar nga shtetasi A. P.

Ky shtetas ka depozituar denoncim për z. Tasim Puci, me pretendimin që ky subjekt nuk ka kryer hetim të plotë në lidhje me kallëzimin penal që ka bërë ky qytetar. Denoncuesi pretendon se për një shtetas të akuzuar për veprën penale "vjedhje duke shpërdoruar detyrën" ka kërkuar në mënyrë të paligjshme ndryshimin e masës së sigurisë nga "arrest në burg" në "detyrim paraqitje".

Nga verifikimi i akteve rezulton se kallëzimi penal i regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, është bërë për veprën penale "vjedhje duke shpërdoruar detyrën" dhe jo për "shpërdorim detyre", sikurse shprehet prokurori në vendimin e tij. Gjithashtu, prokurori i çështjes, Tasim Puci, ka kërkuar para gjykatës një masë më të ulët se ajo që i korrespondon veprës penale për të cilën ishte regjistruar procedimi.

Në lidhje me denoncimin sa më sipër, subjekti iu kërkua të japë shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin E të Kushtetutës.

Në prapësimet e depozituara nga subjekti, për këtë denoncim, ka shpjeguar se:

Nga Komisioni përmendet masa e sigurimit "detyrim paraqitje" caktuar nga prokurori dhe referuar arsyetimit të gjykatës se si masë e përshtatshme do të ishte masa e sigurimit "arrest me burg". Në atë kohë prokuroria kishte varësi hierarkike dhe masa e sigurimit të caktuar për një vepër penale, ciklohej nga drejtuesi i prokurorisë, i cili me të drejtë ka miratuar masën e sigurimit "detyrim për paraqitje". Ky vendim është ankimuar nga shtetasi A. F dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. **, datë 15.1.2014, ka vendosur:

- Miratimin e vendimit nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për sa i përket caktimit të masës së sigurimit "detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore", ndaj shtetasit A. F.
- Shfuqizimin e vendimit të mësipërm për pjesën që ka vleftësuar të ligjshëm ndalimin e shtetasit A.F.

Subjekti depozitoi dhe vendimin me nr. ****, datë 24.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, sipas së cilës është vendosur: Mospranim të ankimit, për anulimin e vendimit të prokurorit "për pushimin e hetimit të çështjes penale nr. ***, datë 7.12.2013, për moslegjitimitet aktiv të tij". Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

2. Denoncim i depozituar nga shtetasja me initiale L. Ç.

Kjo shtetase ka depozituar denoncim për dy subjekte rivlerësimi, ndërmjet të cilëve dhe për subjektin Tasim Puci. Denoncuesja nuk është dakord me vendimmarrjen e prokurorit Tasim Puci për mosfillimin e procedimit penal. Denoncuesja ka ankimuar këtë vendim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, si dhe ka urdhëruar organin e akuzës për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme”.

Në lidhje me këtë denoncim, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se, ndër të tjera, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur shfuqizimin e mosfillimit dhe kryerjen e një sërë veprimesh procedurale.

Vendimi i Gjykatës është ankimuar nga prokurori dhe Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Në vijim, nga prokurori/subjekti i rivlerësimit është arritur në konkluzionin se veprimet e kryera për të cilat ishte bërë kallëzim nuk përbënin veprë penale dhe është kërkuar prej tij në gjykatë pushimi i çështjes.

Pas shqyrtimit të kërkesës, Gjykata ka vendosur të miratojë kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim denoncuesja/L. Ç dhe Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, duke e konsideruar të drejtë kërkesën e prokurorit.

Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar vendimin nr. **, datë 25.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, që ka vendosur: “pranimin e kërkesës së bërë nga prokurori (T. Puci), për pushimin e çështjes penale nr. ** prot., datë 12.12.2018, për veprën penale “falsifikim të dokumentacionit”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

3. Denoncime të depozituara nga shtetasët me initiale M. B. dhe A. J.

Këto denoncuese kanë pretenduar se subjekti i rivlerësimit është i paaftë profesionalisht dhe ka ushtruar presion psikologjik në vazhdimësi, karshi palës së tyre.

Denoncueset kanë pretenduar se për kallëzimin e depozituar prej tyre për “falsifikim dokumentacioni”, nga Prokuroria është vendosur pushim i procedimit penal. Por, në dosje nuk ka vendim të prokurorit. Ky vendim është ankimuar nga denoncueset dhe Gjykata pas hetimit gjyqësor ka vendosur “mospranimin e kërkesës së Prokurorisë Berat për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 13.7.2018, kthimin e akteve organit të akuzës dhe vazhdimin e hetimeve”.

Në lidhje me denoncimin sa më sipër, subjekti iu kërkua të japë shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në prapësime e rezultateve të hetimit, për këtë denoncim ka shpjeguar se në vlerësim të tij, hetimi i kësaj çështjeje është i drejtë dhe në përputhje me ligjin, ku çështja e tyre ka karakter pronësie dhe veprimet e pretenduara prej tyre, si veprime që përbëjnë veprë penale nga persona të ndryshëm fillimisht, të afërmit e familjes së tyre dhe, më pas punonjës të

arkivave shtetërore, veprime këto që i përkasin shumë viteve me parë dhe pasi janë kryer veprimet e nevojshme procedurale është përpiluar kërkesa për pushimin e çështjes penale.

Subjekti ka shpjeguar se u ka bërë të ditur edhe kallëzuesëve se prokurori paraqet kërkesë në gjykatë ku shqyrtohet çështja dhe mund të kuptohet dhe më mirë fakti konkret dhe shkeljet e ndryshme, por kanë qenë kallëzueset ato që nuk donin që çështja të shqyrtohej duke paraqitur kërkesë për përjashtim të çdo gjyqtari që merrte në dorëzim këtë çështje, duke fyer e ofenduar prokurorin, gjyqtarin, sekretarët dhe gjithë prokuroritë e gjykatat në tërësi. Për këtë shkak, subjekti ka shpjeguar se i ka paraqitur Drejtuesit të Prokurorisë kërkesën për heqje dorë nga vazhdimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje, kërkesë e cila është pranuar.

Subjekti, për këtë denoncim, ka depozituar “kërkesë për heqje dorë” nga materiali me kallëzues shtetas M.B dhe A.Q, të datës 26.5.2020, pasi pretendon se ka pasur një material kallëzues të mëparshëm të vitit 2018, me këto kallëzues dhe për këto fakte, duke qenë se është përballur me sjellje fyese nga kallëzueset, ka paraqitur kallëzim penal për të dyja këto shtetase.

Trupi gjykues, në lidhje me denoncimet sa më sipër, vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe në dokumentacionin mbështetës të paraqitur pas prapësimeve, si dhe pasi kreu verifikimet përkatëse referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë shkelje, bazuar në standardet e parashikuara në ligj, në lidhje me kriterin e aftësive profesionale.

Komisioni, gjithashtu, bazuar në informacionet e vëna në dispozicion në lidhje me subjektin e rivlerësimit Tasim Puci, ka marrë dhe ka analizuar edhe 7 çështje të tjera penale. Për 2 çështjet vijuese, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës.

1. Në lidhje me çështjen penale me të akuzuar shtetasin R.H, për veprën penale “falsifikim të dokumenteve zyrtare”, në informacionin që referohet ka rezultuar se subjekti Tasim Puci është përmendur si prokurori i çështjes.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat³⁰, bazuar në kërkesën e Komisionit, ka depozituar dosjen hetimore të çështjes me të pandehur shtetasin R.H, i akuzuar për veprën penale “falsifikim të dokumenteve zyrtare”. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se çështja i është caktuar subjektit të rivlerësimit Tasim Puci, i cili ka bërë regjistrimin e procedimit penal me nr. ***/2013, në ngarkim të shtetasve R.H, etj. Pas administrimit të akteve dhe pyetjes së dëshmitarëve, prokurori i çështjes me vendimin e datës 3.10.2013, ka vendosur “*mosfillimin e procedimit penal*”, për aktin e regjistruar të vitit 2013, pasi fakti nuk parashikohej në ligj si vepër penale.

Më tej, në datën 22.11.2013, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, ka vendosur “*Për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013*”, me arsyetimin se për nevoja të hetimit duhej të kryheshin verifikime të mëtejshme për një kontratë të lidhur ndërmjet Komunës Perondi, Berat, përfaqësuar nga kryetari i komunës, z. R. H, nëse ishte lidhur në përputhje me ligjin dhe nuk ishin cenuar interesat e shtetit dhe të shtetasve të tjerë.

³⁰ Shkresë nr. **** prot., datë 22.1.2021.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes rezulton se kjo kontratë ishte një provë, të cilën subjekti i rivlerësimit e kishte cituar edhe në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, pra, nuk ishte provë e re për organin e akuzës. Referuar vendimit të shfuqizimit të titullarit të institucionit nuk gjen mbështetje vendimi i prokurorit Tasim Puci, datë 3.10.2013, me të cilin ka vendosur “*mosfillimin e procedimit penal*”, për procedimin nr. ***, të vitit 2013, pasi fakti nuk parashikohej në ligj si vepër penale.

Ky procedim është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, ku është zhvilluar gjykimi dhe përfundimisht prokurori Tasim Puci, ka kërkuar përpara gjykatës:

- Deklarimin fajtor të pandehurit R.H, për veprën penale “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim. Nisur nga rrezikshmëria e vogël e autorit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, të pezullohej ekzekutimi i tij, duke u vënë në provë për një periudhë 18-mujore.

- Deklarimin fajtor të shtetasve E.M, R.P, etj., akuzuar për veprën penale të “*falsifikimit të dokumenteve*”, parashikuar nga neni 186, i Kodit Penal dhe dënimin e tyre me 8 muaj burg. Nisur nga rrezikshmëria e vogël e autorit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale të tij, të pezullohet ekzekutimi i tyre duke u vënë në provë për një periudhë 18-mujore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit R.H, për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të tij, duke u vënë në provë për një periudhë 18-mujore.

- Deklarimin e pafajshëm të shtetasve E.M, R.P, etj., akuzuar për veprën penale “*falsifikim të dokumenteve*”.

Subjekti ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të rrethit, si dhe ka kërkuar të njëjtat masa shtrënguese dhe deklarin fajtor të shtetasve që gjykata i nxori të pafajshëm.

Nga aktet rezulton se subjekti, për të njëjtën çështje vendosi “*mosfillimin e procedimit penal*”, dhe pasi ky vendim u shfuqizua nga eprori, e çoi çështjen për shqyrtim në gjykatë dhe kërkoi deklarin fajtor të të pandehurve, si dhe apeloj vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: “Lidhur me këtë çështje është paraqitur një denoncim nga shtetasi M.T, që bënte fjalë për kontratën e shitblerjes nr. ****, datë 26.3.2013, të nënshkruar nga shtetasi R.H, në cilësinë e kryetarit të komunës, ku u janë shitur shtetasve E. M, M.P, R. P dhe B.P, pasuri të ish-kooperativës të fshatit Tapi, Kuçovë dhe, konkretisht, furrë, larëse gruri dhe mulli bloje, duke u paguar dhe vlerat e caktuara monetare të tyre nga përfituesit.

Këtyre dokumenteve të paraqitura nga pala blerëse në kontratë, objektet që kanë përfituar nga ish-kooperativa bujqësore kanë sip. 256 m², por gjendja faktike në kohën e lidhjes së kësaj kontrate nuk përputhet me këto dokumente. Nuk përputhet, pasi në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 26.3.2013, ekziston vetëm objekti “furrë” dhe sipërfaqja e

këtij objekti është 95 m², pasi pjesa tjetër nuk ekziston që prej vitit 1997, kohë kur janë shkatërruar.

Sipas këtyre dokumenteve të paraqitura nga pala blerëse në kontratë, objektet që ata kanë përfituar nga ish-kooperativa bujqësore kanë sip. 256 m², por gjendja faktike në kohën e lidhjes së kësaj kontrate nuk përputhet me këto dokumente.

Nuk përputhet, pasi në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 26.3.2013, ekziston vetëm objekti “furrë” dhe sipërfaqja e këtij objekti është 95 m², pasi pjesa tjetër nuk ekziston që prej vitit 1997, kohë kur janë shkatërruar.

Lidhur me këtë kontratë, e cila është dërguar në ZVRPP-në Kuçovë, kjo e fundit nuk ka kryer veprime duke i propozuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme “refuzimin e kërkesës për regjistrim“, për arsye se kontrata noteriale është konstatuar me mangësi në formë dhe në përmbajtje.

Nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me urdhrin nr. 306, datë 22.4.2013, është urdhëruar “refuzimi i kërkesës së z. E. M me objekt regjistrimin e kontratës së shitblerjes nr. ****, datë 26.3.2013”.

Nisur nga fakti se kjo kontratë nuk kishte sjellë pasojë, pasi nuk është pranuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nga prokurori është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Duke qenë se pas paraqitjes në prokurori të kallëzuesit M.T, nga subjekti është kërkuar të konsultohet rasti me titullarin e prokurorisë dhe pas konsultës në tërësi dhe me prokurorë të tjerë, është rënë dakord që çështja të regjistrohet, pasi veprimi është kryer nga palët, pavarësisht se nuk ka sjellë pasojë, që nuk ka ardhur nga vullneti i të pandehurve dhe për këtë fakt, në mirëkuptim është vendosur shfuqizimi i vendimit të mosfillimit.

Me marrjen e çështjes është bërë regjistrimi i procedimit, regjistrimi i emrave të pandehurve dhe njoftimi i akuzës dhe dërgimi në gjykatë dhe çështja është përfaqësuar nga unë si prokuror, në të cilën është kërkuar dënimi i të gjithë të pandehurve siç është përshkruar dhe nga ana juaj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur deklarinimin fajtor vetëm të të pandehurit R. H dhe pafajësi për të pandehurit e tjerë.

Çështja është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, nga prokurori Tasim Puci dhe Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat”.

Komisioni arsyeton se megjithëse subjekti fillimisht ka vendosur “*mosfillimin e procedimit penal*”, dhe më vonë në kushtet kur në aktet e dosjes nuk kishte prova të reja, ky vendim është shfuqizuar nga eprori i subjektit, ky i fundit ka vijuar me hetimin e çështjes dhe e ka çuar para gjykatës duke vepruar në përputhje me ligjin procedural dhe material duke kërkuar fajësinë e të pandehurve.

Në këto kushte, subjekti pas një veprimi procedural, i cili u shfuqizua nga eprori nuk mund të konsiderohet i papërshtatshëm për vlerësimin profesional apo me mangësi në punë, pasi vetëm një rast i evidentuar nuk mjafton për të përshkruar të gjithë veprimtarinë e tij profesionale.

2. Në lidhje me çështjen penale ndaj shtetasit S. T, i cili akuzohet për veprën penale të përvetësimit të shumave të parave të pensioneve, informacioni referon se avokati A. S ka marrë përsipër ndërmjetësimin me prokurorin Tasim Puci, me qëllim uljen e dënimit penal, pasi dënimi sipas shtetasit S.T, shkon deri në 10 vjet burgim.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat referon se shtetasi S.T është akuzuar për veprën penale “përvetësimi i shumave të parave”, parashikuar nga nenit 135 i Kodit Penal por rezulton që për këtë shtetas ka pasur disa procedime, si dhe një procedim të trajtuar nga prokurori Tasim Puci me nr. **, datë 10.10.2018, për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”. Vlera totale e pretenduar, si e vjedhur nga Posta Shqiptare, është rreth 165.000 lekë.

Ky procedim është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, është gjykuar dhe nuk është bërë ankim nga prokurori.

Në kërkesën për gjykim të çështjes penale, të hartuar nga subjekti i rivlerësimit Tasim Puci, nuk evidentohet masa e dënimit e kërkuar nga prokurori. Në dosje nuk ndodhen pretendimet përfundimtare apo parashtrime të prokurorit, përpara gjykatës.

Në faqen e parë të fashikullit “Formulari mbi përfundimin e çështjes”, ka të cilësuar që në konkluzionet përfundimtare të prokurorit të datës 12.6.2019, është kërkuar si masë dënimi, për veprën penale 9 muaj burgim, është kërkuar ulja e 1/3 së dënimit referuar nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe aplikimi i shërbimit të provës sipas nenit 59 të Kodit Penal.

Gjykata ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit, duke e dënuar me 6 muaj burgim në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, përfundimisht është dënuar me 4 muaj burgim, si dhe aplikimi i shërbimit të provës sipas nenit 59 të Kodit Penal.

Referuar nenit 135 të Kodit Penal, për veprën penale “vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën”, parashikohet se: “Vjedhja e pasurisë e kryer nga personi, që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë, apo duke shpërdoruar detyrën, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet”.

Nga aktet e dosjes rezulton se përfaqësues të të pandehurit janë shtetasit A dhe A.S.

Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar se për çështjen penale ndaj shtetasit S.T, ku Komisioni mendon se masa e dënimit duket më e ulët sa parashikon vepra, argumenton se në fillimet e punës së tij sanksionin e merrte si të shkëputur nga vepra penale.

Subjekti, me kalimin e viteve dhe përvojën në punë, kupton se sanksioni është pjesë e lidhur e faktit dhe elementeve të veprës penale, siç është intonacioni në muzikë.

Sanksioni në veprën penale duhet të vijë në harmoni me faktin e ndodhur, subjektet e procedimit, pasojën e ardhur, mënyrën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, mundësinë e rikuperimit të pasojave dhe, në përfundim, ndëshkimin e autorit.

Në rastin konkret, përveç autorit, kemi dhe persona të dëmtuar, të cilët nuk kanë arritur të marrin pensionet që u takonin, për shkak të sjelljes së papërgjegjshme dhe kriminale të autorit, duke i përvetësuar këto shuma.

Me një dënim me burgim të autorit, në rastin konkret, realizohet vetëm ndëshkimi i autorit, ndërsa pasojat e tjera, siç është edhe rikuperimi i dëmit të shkaktuar, mbetet i parealizuar.

Për këtë shkak, një presion pozitiv ndaj të dënuarit dhe dhënia e një dënimi të tillë, bën që dhe autori të ndëshkohet dhe të mundësojë shlyerjen e dëmit të shkaktuar. Pra, edhe për këtë rast, dënimi është objektiv.

Komisioni arsyeton se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë të pranueshme dhe bindëse duke konsideruar shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale, mundësinë e rikuperimit të dëmit, si dhe parashikimin në ligj që për këtë veprë penale dënimi maksimal i parashikuar është deri në 10 vjet, por ndërkohë në gjykimin e masës së dënimit merren në konsideratë të gjitha rrethanat lehtësuese sa më sipër.

Në përfundim, pas analizimit të 7 dosjeve, nuk ngrihen dyshime për veprime të subjektit të rivlerësimit Tasim Puci, në shkelje të ligjit procedural apo material, që të jetë në nivel të aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e prokurorit Tasim Puci dhe sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, për kriterin e vlerësimit të pasurisë në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i rivlerësimit nuk arriti t'i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke pasur parasysh se nuk provoi: (i) marrëdhënien e vjehrrit me apartamentin; (ii) burimet e ligjshme financiare të vjehrrit dhe të familjarëve të bashkëshortes për blerjen e këtij apartamenti; dhe (iii) nevojën e vjehrrit për të kryer këtë investim në Tiranë, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Tasim Puci, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha